



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Shaban Shabani, Kryetar i Komunës së Dragashit Betim Merdiu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Dragashit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Data:30.05.2018
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Aktit të Komunës së Dragashit	Nr. 020-632
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 060/01- 9741/2 për miratimin e raportit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së), për vitin 2017 dhe Plani i veprimtimit për vitin 2018
I miratuar më datë: 15.05.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë:29.05.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

ZA:	Shaban Shabani , gradonačelnik Opštine Dragaš Betim Merdui , predsedavajući Skupštine opštine Dragaš	
Kopija	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević , ministar MALS-a, <i>[Signature]</i> Rozafa Ukimeraj , generalna sekretarka MALS-u, <i>[Signature]</i>	
Od:	Shkelqim Jakupi , rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS <i>[Signature]</i>	Datum, 30.05.2018. Br. 020-632
Predmet:	Potvrda zakonitosti akata opštine Dragaš.	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine koje je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 060/01- 9741/2 za usvajanje izveštaja Opštinskog saveta za bezbednost u zajednici OSBZ-a za 2017. godinu, i akcioni plan za 2018.
Usvojena dana, 15.05.2018. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 29.05.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadrđaja gore navedenog opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal
01 Nr.060-01-9741/2
Dt.15.05.2018
D r a g a s h

28 05 2018

-01-020-632

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit, në seancën e dt.15.05.2018 të Kuvendit Komunal të Dragashit, pas shqyrtimit paraprak, miratohet ky:

V E N D I M

- I. MIRATOHET Raporti i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBJ), për vitin 2017 dhe Plan i Veprimit, për vitin 2018.
- II. Për implementimin e vërejtjeve të dhëna obligohen KKSBJ-ja, kryetari me shërbimet tjera të Komunës-Dragash.
- III. Për veprimet e mëtejme të njoftohet Kuvendi Komunal i Dragashit.
- IV. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga regjistrimi në protokolin e Zyrës së MAPI-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web-faqen e Komunës-Dragash.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës-Dragash z.Salim Jenuzi,
- Drejtorateve të Komunës-Dragash,
- MAPI-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH

Kryesuesi
Betim Merdriu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality

Skupština Opštine
01 Br.060-01-9741/2
Dt.15.05.2018 god.
D r a g a š

23 25 2018
201- 020- 632

Na osnovu člana 17 Zakona o Lokalnoj Samoupravi i člana 32.2. Statuta Opštine Dragash, na sednici Skupštine Opštine Dragash, održane 15.05.2018. godine, nakon prethodne rasprave, donosi se sledeća:

ODLUKA

- I. **USVAJA SE** Izveštaj Opštinskog Odbora za Bezbednost u Zajednici (OOBZ-a), za 2017. godinu i Plan Delovanja, za 2018. godinu.
- II. O implementaciju datih primedbi obavezuju se OOBZ-a, predsednik i direktorati sa ostalim službama Opštine.
- III. O preduzetim merama upoznati Skupštinu Opštine Dragash.
- IV. Ova Odluka stupa na snagu 15 dana nakon registra u protokol MAUS-a, kao i 7 dana od objavljivanja na web-stranici Opštine Dragash.

Dostavlja se:

- Predsedniku Opštine Dragash g. Shaban Shabani
- Direktoriatima Opštine Dragash,
- MAUS-u (Pravnoj Kancelariji)-Priština, i
- Arhivi

SKUPŠTINA OPŠTINE-DRAGAŠ

Predsedavajući
Betim Merdhu



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

RAPORTI
I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI, për vitin 2017
&
PLANI I VEPRIMIT, për vitin 2018

Dragash, 04.04.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

Raporti

i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2017

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi për Komunën e Dragashit, edhe gjatë periudhës së vitit kalendarik-2017, veprroi sipas përbërjes së tij të themeluar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Dragashit 01 Nr.020-10130/3 të dt.25.06.2014, duke u angazhuar konform obligimeve dhe kompetencave të parapara me Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Sipas këtij UA, konkretisht, nenit 4 të Udhëzimit të larpërmendur, në Këshill ishin të përfshirë përfaqësues të organeve kompetente komunale dhe të subjekteve tjera të rëndësishme për aspektin e sigurisë në Komunë e më gjerë. Për dallim nga vitet e mëparshme, kur ishin mbajtur, s' paku, 6 takime të këtij Këshilli, gjatë vitit të shkuar 2017 u mbajtën 4 takime, apo 2 takime më pakë se sa parashihehej me UA e që ishte si rrjedhojë e zgjedhjet lokale të mbajtura gjatë gjatë vitit 2017. Sidoqoft, gjatë vitit kalendarik-2017 dhe 4 takimeve që kishte ky Këshilli i Sigurisë, u veprua në kuadër të obligimeve dhe kompetencave që kishin të bënin me situatën e gjithmbarshme të sigurisë te ne. Fatmirësisht, në takimet e organizuara të Këshillit, situata politike dhe e sigurisë, konstatoheshin stabile dhe vlerësohej pozitive, madje ndër më stabilet në nivel të rajonit dhe mbar Kosovës, e përcjell me lëvizje të lirë qytetare dhe mardhënie stabile dhe të tolerancës ndëretnike te ne të cilat nuk janë shprehur negativisht në gjendjen e sigurisë dhe disponimin e gjithmbarshëm të popullatës në të dy trevat tona etnike-Opojës dhe Gorës. Si e këtill, komuna e jonë është cilësuar edhe nëpër raportet e organeve të më të larta të sigurisë në nivel të Rajonal dhe të mbar Republikës së Kosovës, apo në takimet e organizuara nga: KFOR-i, OSCE-ja dhe organizatat tjera ndërkombëtare e vendore që interesoheshin dhe vëzhgonin çështjet e sigurisë.

Siç u theksua më lartë, gjatë vitit kalendarik-2017, përkatësisht në 4 takimet e mbajtura të KKSBS-së te ne, u trajtuan çështjet, si vijon:

Takimi i I-rë (parë) u mbajt më 08.02.2017, me këtë rend të ditës:

- Miratimi i Procesvebalit, nga takimi i mëparshëm i Këshillit,
- Njoftimi me situata aktuale politike dhe e sigurisë në Komunë, në mes të 2 takimeve të Këshillit,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së KKSBS-së për vitin 2016 & Planit të Punës/2017,
- Eventuale...

Takimi i II-të (dytë) u mbajt më 04.04.2017, me këtë rend të ditës:

- Miratimi i Procesverbalit,
- Situata politike dhe e sigurisë në Komunë në mes të dy takimeve të Këshillit dhe përgatitjet për festat e Majit, dhe
- Eventuale...

Takimi i III-të (tretë) u mbajt më 16.06.2017, me këtë rend të ditës.

- Miratimi i Procesverbalit...
- Situata politike dhe e sigurisë në Komunë gjatë sezonit veror dhe para fillimi vitit shkollor, dhe
- Eventuale...

Takimi i IV-të (katërtë) u mbajt më 19.08.2017, me këtë rend të ditës:

- Miratimi i Procesverbalit,
- Njoftimi me gjendjen e sigurisë në mes të dy takimeve dhe në vigjile të zgjidhjeve lokale, dhe
- Eventuale...

Si zakonisht, edhe në këto takime të Këshillit, ato u kryesuan nga kryetari i Komunës, që sipas funksionit, njëherësh është edhe kryetar i këtij Këshilli. Fillimisht, shqyrtohej dhe miratohej Procesverbalit nga takimi i mëparshëm, kuse në pikat e 2-ta të takimeve, nga komandanti (apo zëvendësi) i Stacionit Policor të Kosovës në Komunës së Drapashit referohej për gjendjen aktuale politike të sigurisë në mes të dy takimeve të Këshillit e cila, për vitin 2017, parimisht, verësohej njaft stabile dhe u klasifikuar sipas këtyre specifikave të ngjarjeve: vepra penale, vepra penale kundër pronës, lëndime të lehta trupore, aksidente trafiku dhe vepra të ndryshme kundërvajtëse (që të kualifikuara-si të tilla gjenden në evidencat e Policisë...) dhe janë paraqitur tek organet e zbatimit të ligjit për procedurat të mëtejme në kualifikimin e tyre dhe ndërmarrjen e masave adekuate ligjore. Sipas statistikave të paraqitura në takimet e Këshillit..., rezulton se një shtim të lehtë kanë shënuar veprat e natyrës penale, vjedhjet dhe dënimet në trafik, kurse ka zvogëlim të atyre kundërvajtëse dhe aksidentet në trafik, sipas tabelës në vijim:

	2016	8/ 2017
Rastet e inicuar	339	160
Veprat penale	243	131
Vjedhje	71	32
Vepra kundërvajtëse	96	24
Aksidente në trafik	58	31
Dënime në trafik	1799	2527

Sipas kësaj gjendjeje, marr, në tërësi, konstatim i përgjithshëm i takimeve të Këshillit ishte se situata politike dhe e sigurisë ka qenë në nivel të kënaqshëm, me liri të lëvizjes së qytetarëve, funksionim normal të organeve komunale e shtetërore dhe pa ndonjë situatë e cila do të rëndonte dukshëm gjendjen e gjithmbarshme politike dhe rethanat e funksionimit normal të pushtetit lokal.

Në këto takime, pos anëtarëve të Këshillit, e mirëpritur ka qenë edhe pjesëmarrja e përfaqësuesëve të OSCE-së dhe të ministrive përkatëse-MBPrendshme të MAPL-së (që njoftoheshin për datën dhe me agjendën e takimeve), si dhe OJQ- të e mediat e interesuara. Ndërkaq, në frymën e tolerancës dhe mirëkuptimit, nga anëtarët dhe sipas sugjerimeve të mysafirëve prezent në takime, inicoheshin edhe çështje tjera me interes për qytetarët, komunën dhe mbarvajtjen e punës së Këshillit, siç ishin:

- Kalimet ilegale të kufirit dhe aktivitetet për parandalimin dhe zbulimin e tyre, duke u kërkuar angazhim më i madh i organeve të policisë me prokuroritë dhe gjykatat, për punë sa më efektive në parandalimin e dukurive negative të cilat reflektohen në sferën e sigurisë së gjithmbarshme në Komunë. Në këtë kontekst është edhe vendosja e kamerave të sigurisë në ato vende ku janë paraparë me projektin e UNDP-së, por që ende nuk kanë përfunduar për t'u vendosur aty ku ishte paraparë me Projektin që mbetet detyrë vijuese,
- Siguria në shkollë dhe respektimi i mësimin me evitimin e ekscesëve të mundshme kanë qenë tema për të cilat vazdimisht është informuar në raportimet e Policisë në Këshill e që, fatmirësisht, krahasuar me vitin paraprak, falë angazimit të mësidhënësëve, prindërëve, patrullimeve policore dhe vetëdijesimit të nxënësëve janë shënuar trende më pozitive se sa më parë,
- Çështja e bashkëpunimit ndërkufitar të Komunës sonë me komunat kufitare të 2 shteteve për reth-Shqipërisë e Maqedonisë, përfshi këtu sidomos nevojën e funksionimit e zyrtarizimit të rrugëve e vendkalimeve adekuate kufitare, si dhe nevojën për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe realizimi i projekteve me interes reciprok e që do të përkraheshin nga donatorët vendor e ndërkombëtar,
- Nevojat e bashkëpunimit të komunitetit me KLSB-në dhe këshillat lokale të sigurisë (e që të në, aktualisht, funksionon vetëm KLSB-së në Krushevë i cili KL, pos bashkëpunimit, është dëshmuar edhe me realizim të projekteve....), por që është synim edhe për në lokalitet tjera,
- Njoftimet për sigurinë në trafik dhe angazhimet për rregullimin e rregullave dhe përmirësimi i kushteve nëpër rrugët tona, si dhe sinjalizimi i tyre me shenja adekuate trafiku,
- Çështjet e respektimit të orareve të punës nëpër lokale afariste dhe ruajtja e rendit dhe qetësisë publike në to. Siç është konstatuar, këtë dukuri sidomos janë evidente gjatë sezonit veror kur, zakonisht, në Komunë arrijnë kurbetçarët dhe shtohet fluksi i lëvizjes së tyre në trafik dhe vendet publike përmes organizimit të ahengjeve private, konsumimit të alkoolit, mosrespektimit të rregullave në trafik me tejkalime të shpejtësisë dhe ngarjen e veturave nën ndikim të alkoolit që janë konsideruar se, shpesh-herë, kanë qenë shkaqe të drejtpërdrejta të prishjes së rendit e qetësisë publike e që shoqërohen edhe me ekscese dhe intervenime policore të cilat vepra kanë kërkuar edhe arrestime e dënime të cilat janë shqiptuar,
- Mirëmbajtja e higjienës dhe ruajtja e ambijentit kanë qenë dhe ngelin tema të cilat brengosin dhe kërkojnë angazhim edhe për të ardhmen, nga së ballafaqohemi me mungesë ndërgjegjjeve

- dhe hudhje të pakontrolluar të tyre dhe mospagesën e obligimeve nga qytetarët tonë ndaj kompanisë "Hidro-Higjiena", që, në ardhmen, kërkon angazhim më të madh të shërbimeve të inspekcioneve, Policisë dhe gjykatave në shqiptimin e dënimeve ndaj personave dhe ndërmarrjeve të pandërgjegjshme të cilat i kontibuojnë ndotjes së ambientit me mbeturina shtëpiake dhe të ngurta,
- Dukuria e cila është shqyrtuar dhe vlerësuar si brengosëse për t'u evituar ka qenë dhe mbetet problematika mjaft e shprehur e qenëve endacak e cila, edhe përkundër disa masave perventive që janë ndërmarr, ka nevojë që të gjurmohet për zgjidhje në nivel komunal e më gjerë me forma sa më adekuate trajtimi, nga se numri i tyre vazhdimisht po shtohet madje edhe sjelljen e tyre nga viset jasht komunës sonë,
 - Nga DEMSHpërtimit dhe Policia është referuar edhe për gjendjen në parandalimin e dukurive të zjarreve dhe zjarrvënieve, si dhe në mirëmbajtjen e rrugëve-sidos gjatë sezonit dimëror.
 - Në bashkëpunim me ICITAP-in amerikan janë organizuar takime e aftësimit të 60 vijuesëve për veprime emergjente të sigurisë, si dhe nevoja e themelimit dhe funksionimit të KLSB-së nëpër fshatarat tona në të cilin drejtim duhet motivuar e vetëdijësuar popullatën për ardhjen në shprehje të vullnetarizimit në secilin mjedis të komunës sonë.

Në këtë drejtim, Këshilli ka shqyrtuar edhe çështje tjera që i ka imponuar momenti, apo që i kanë inicuar anëtarët e Këshillit dhe mysafirët prezent që kanë monitoruar dhe nderuar punën e Këshillit , me pjesëmarrje e tyre.

Prandaj, sipas obligimeve e kompetencave të KKS-së, e në bazë të gjendjes së këtyre dhe rëndësisë së çështjeve për trajtim, për të ardhmen, nevojitet shtim i përgjegjësive, që secili subjekt komunal , organ shtetëror apo edhe anëtarë i Këshillit, duke vepruara sipas dinamikës së punës së Këshillit dhe me përgjegjësisë së plotë në iniciimin e çështjeve dhe përmbushjen e obligimeve të parapara ligjore në sferën e sigurisë qytetare.

Zyrtar-koordinator i Këshillit:

Azbi Halili



Kryetari i Këshillit :

Shaban Shabani



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

Në bazë të nenit 6.1 dhe 9.1.7 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 të MPB-së – 03/2012 MAPL-së për kompetencat dhe obligimet e këshillave komunale për siguri në bashkësi, KKSJ-ja në Dragash, në mbledhjen e mbajtur më 04.04.2018, miraton këtë :

PLAN TË VEPRIMIT

TË KKSJ-SË DRAGASH, për vitin 2018

Nr.rend.	Çështjet-temat për shqyrtim	Muaji	Shqyrton & miraton
1.	<ul style="list-style-type: none">- Gjendja në trafikun rrugor gjatë sezonit dimëror,- Fillimi i gjysmëvjetorit shkollor dhe gjendja e sigurisë në shkolla	Mars-Prill/2018	KKSJ-ja
2.	<ul style="list-style-type: none">- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor-2017 dhe Planit të Veprimit 2018 të KKSJ-së,- Çështja politike dhe e sigurisë gjatë 3-mujorit parë-2018,- Shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim ndërkufitar me projekte e vizita të përbashkëta	Mars-Prill/2018	KKSJ-ja & Kuvendi Komunal
3.	<ul style="list-style-type: none">- Çështja politike dhe e sigurisë gjatë 6-mujorit dhe sezonit pranveror ,- Njoftimi me problematikën e zjarreve dhe zjarrvënies dhe ruajtjes së pyjeve në Komunë dhe shtimi i masave të sigurisë, për këtë,- Siguria në shkolla dhe mbarvajtja e mësimit,- Dukuria e kalimeve ilegale të kufirit dhe evitimi i vjedhjeve që reflektohen, veçmas në zonat kufitare	Maj-Qershor/2018	KKSJ-ja
4.	<ul style="list-style-type: none">- Çështja politike dhe e sigurisë në prag të fillimit të pushimeve verore dhe pritja e kurbetçarëve,- Njoftim me gjendjen-problematikën e qenëve endacak në Komunë,- Themelimi i KLSB-së në terren	Korrik-Gusht/2018	KKSJ-ja
5.	<ul style="list-style-type: none">- Çështja politike dhe e sigurisë gjatë 9-mujorit dhe në vigjile të fillimit të vitit të ri shkollor 2018/2019,- Njoftimi me gjendjen në trafik dhe siguria në punën e lokaleve gjatë sezonit veror të përcjellur me fluksin e kurbetçarëve gjatë pushimeve	Shtator-Tetor/2018	KKSJ-ja
6.	<ul style="list-style-type: none">- Çështja politike dhe e sigurisë para fundvitit dhe përgatitjet për sezonin dimëror,- Njoftim me përgatitjet dimërore të SHZSHHPublike për mirëmbajtjen e rrugëve locale gjatë sezonit dimëror	Nëntor-Djetor/2018	KKSJ-ja & Kuvendi Komunal

Vërejtje: Ky Plan i Veprimit për vitin 2018 i KKS-së për Komunën e Dragashit, krahas analizës-raportim të rregullt të kompetentëve rreth gjendje së sigurisë në Komunë dhe çështjeve të parapara për shqyrtim sipas dinamikës së lartcekur, ngel i hapur edhe për çështje të tjera që do të inicoheshin nga vetë anëtarët e KKS-së, organet shtetërore e komunale, subjekte politike, OJQ-të dhe monitorues të punës së KKS-së. Pa dyshim se iniciatvat e tilla, eventuale, do të inkorporoheshin dhe do të ishin pjesë përbërëse e këtij Plani, për t'u shqyrtuar sipas dinamikës dhe momenteve që imponohen për rethanat e Komunës së Dragashit, me qëllimin kryesor të mbarvajtjes së punëve nga aspekti i sigurisë në Komunë dhe më gjerë.

Zyrtari-koordinator i KKS-së:

Azbi Halili



Kryesuesi i KKS-së Dragash

Shaban Shabani, d.v.